

Nr. 4623 Prot.

Tiranë, më 03/06/2025

Nr. 207 Prot.

Tiranë, më 03/06/2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë, 03.06.2025, midis palëve :

1. **“SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR”**, me adresë : Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, me NIPT: **J72216003P** Përfaqësuar nga **Znj. REME XHOLI**, në cilësinë e Drejtorit të Pergjithshëm;  
Dhe
2. **“CARITAS SHQIPTAR”**, Ent i Kishës Katolike, me seli ligjore në Tiranë dhe me adresë Rr. “Don Bosko”, e njohur dhe regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6415 datë 03.10.1995, si dhe me ndryshimet e tjera përkatëse të depozituara në regjistrin e OJF-ve të kësaj Gjykate, përfaqësuar nga **Znj. Juljana Reso**, në cilësinë e Drejtorit Kombëtar,

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i Marrëveshjes është bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet **Caritas Shqiptar dhe Shërbimit Social Shtetëror**, sipas fushave të veprimit me interes të përbashkët dhe me fokus kryesor **mbështetjen e kategorive të ndryshme shoqërore në nevojë**, me qëllim përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Dispozitat e kësaj marrëveshje do të interpretohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

Palët bien dakord për:

- 2.1 Koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim forcimin e bashkëpunimit për mbështetjen e kategorive shoqërore në nevojë.
- 2.2 Angazhimin për të ftuar personelin/stafet respektive në aktivitete me qëllim ndërtim kapacitetesh si: trajnime, workshope, vizita studimore, si dhe për të marrë pjesë në këto aktivitete.
- 2.3 Referimin e rasteve nga ana dy institucioneve për ofrimin e mbështetjes për persona në situatë vulnerabiliteti si dhe në menaxhimin e rasteve në ofrimin e mundësive për integrim afatgjatë.
- 2.4 Të sigurohet përfshirje në procese apo inisiativa Advokuese dhe/ose konsultuese për rishikimin dhe draftimin e rregullimeve ligjore sipas fushave të veprimit, në mbështetje të kategorive në nevojë.

- 2.5 Palët angazhohen të kontribuojnë në mënyre të ndërsjelltë me informacionet, ekspertizën dhe eksperiencën e tyre në përgatitjen e dokumenteve të ndryshme që lidhen me aktivitete të përbashkëta si: raporte, relacione.
- 2.6 Palët bien dakort të bashkëpunojnë në projekte duke qënë të hapura për partnership dhe nisma të përbashkëta që kontribuojnë kryesisht në përmirësimin ofrimit të shërbimeve për të gjitha kategoritë shoqërore në nevojë, në koordinim me njësitë e qeverisjes vendore.

### **Neni 3 Marrëveshje shtesë**

Në vijim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, Institucionet e varësisë mund të aplikojnë për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta shtesë, me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të vullnetit të palëve.

### **Neni 4 Konfidencialiteti**

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do t'i komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
3. Çdo Palë, nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe /ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe/ose Donatorin përkatës.

### **Neni 5 Kohëzgjatja dhe disponueshmëria**

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare, me të drejtë rinovimi.
2. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar më shkrim 1 (një) muaj përpara palën tjetër.

### **Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkëljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negociimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 2 (dy) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila Palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë organeve kompetente.

**Neni 7**  
**Dispozitat e fundit**

1. Palët angazhohen të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 5 të saj;
2. Marrëveshja mund të ndryshohet apo rinovohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga secila palë;
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Ajo hartohet në 4 kopje të barazvlefshme, nga dy kopje për secilën palë.

**SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

**Reme XHOLI**

**DREJTOR I PËRGJITSHËM**



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR  
TIRANË  
MINISTRIA  
E SHËRBIMIT DHE MBROJTJES SOCIALE

**CARITAS SHQIPTAR**

**Juljana RESO**

**DREJTOR KOMBËTAR**



CARITAS SHQIPTAR  
ALBANIA